

Sinjalizime

Ekskluzive | Sherri mes vëllezërve për biznesin në Prizren përfundon me bastisje në Ferizaj- njëri në pranga, Policia sekuestron armë e municion



Sinjali.com

17 Korrik 2026 08:08



Një konflikt mes dy vëllezërve për çështje biznesi ka përfunduar me arrestim, bastisje në dy lokacione dhe sekuestrim të armëve e municionit, raporton Sinjali.

Sinjali mëson ekskluzivisht se i arrestuari është B. Sh. rreth 35 vjeç , i cili dyshohet se ka kanosur vëllain e tij, S. Sh. rreth 45 vjeç, pas një mosmarrëveshjeje lidhur me bizneset e tyre.

Sipas burimeve të Sinjalit, viktimja është paraqitur në nënstacionin policor në Reçan të Prizrenit, ku ka raportuar se ishte kërcënuar nga vëllai i tij.

Pas denoncimit dhe me urdhër të Prokurorit të Shtetit, Policia ka zhvilluar bastisje në dy prona të të dyshuarit, njëra në Ferizaj dhe tjetra në fshatin Koshare.

Gjatë kontrolleve janë sekuestruar:

- një pushkë gjuetie;
- një pushkë ajrore e dëmtuar;
- 31 fishekë të pushkës së gjuetisë;
- një karikator;
- dy këllëfë pistoletash;
- një thikë;
- një jelek gjuetie.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se pas përfundimit të veprimeve hetimore, ndaj B. Sh. është iniciuar procedurë për veprat penale *"Kanosje"* dhe *"Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve"*.

Me vendim të Prokurorit kujdestar, B. Sh. është dërguar në ndalim për 48 orë, ndërsa hetimet për zbardhjen e plotë të rastit janë në vazhdim.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Policia

Prizren

Ferizaj

Rrahje

bastisje

vëllezërit

Pronë

Të tjera:



Me çekić në duar tentoi të vidhte në një market, kapet 14-vjeçari në Krujë

Shqipëri




Ky është shqiptari që u gjet i vdekur në rrugë të Anglisë

Diasporë



E rëndë në Vlorë, makina e Policisë Bashkiake përplas një fëmijë

Shqipëri



Ekskluzive | Tre persona arrestohen për deklarim të rremë në gjykim për tentim-vrasje në...

Sinjalizime



Ekskluzive | E goditi me shuplakë të miturin dhe videoja u bë virale – Policia arreston 19-...

Sinjalizime



Para false në ProCredit Bank – sekuestrohen 573 euro, nis hetimi

Sinjalizime



Ekskluzive | Shkuan për një rast kanosjeje, Policia zbulon arsenal armësh në një restora...

Sinjalizime



Ekskluzive | Plagosja me pesë plumba në Pejë: Vetëdorëzohet i dyshuari, Sinjali zbulu...

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhome Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kujde
Të tjera